



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:245340

Datë: 20.06.2024

Numri i dokumentit: 05840969

AC-I-23-0106

Në ankesën e

Paditësja/Ankuesja

K.R.U."R"sh.a, Gjakovë.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përberë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe, Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur sipas ankesës së paditëses të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-4193 të datës 07 shkurt 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 20 qershor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditëses refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-13-4193 i datës 07 shkurt 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me 30 dhjetor 2013, paditësja e dorëzoi në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) PRZ067-0003, të datës 02 dhjetor 2013, me të cilin ka kërkuar kompensimin për fatura të pa paguara, në shumë prej 1,399.73 euro nga NSH "KB Bashkimi"-Xërxë", (në likuidim). Paditësja ka pohuar se bazueshmëria e vendimit në nenin 374 të Ligjit për Kontratat dhe Detyrimet (GZ 29/1978) se" në varësi të dispozitave të mësipërme, kërkesa duhet të jetë para gjykatës apo ndonjë autoriteti tjetër kompetent brenda tri viteve nga momenti kur ndërmarra të mos ketë kryer kundrejt parashtruesit obligimet e saj që rrjedhin nga marrëdhënia tregtare, e që është tri vite nga viti 2009 kur parashtruesit nuk i është kryer pagesa e faturave, e kundërshton në tersi. Paditësja pohon se nuk ka parashkrim të kërkesës karshi një autoriteti jo gjyqësor andaj vendimit i AL është në kundërshtim me procedurën e privatizimit me të cilin ka udhëhequr ky autoritet. Paditësja me tej pohon se ky është një diskriminim që po i bëhet kreditorëve duke i vlerësuar kërkesat si të parashkruara nga një autoritet jo gjyqësor me Shtojcën e Ligjit nr.04/L-034 për AKP- në me qëllim të vlerësimit të këtyre borgjeve si të pas aftshme e cila nxirret me vonë dhe me këtë diskriminon kreditorët duke i konsideruar borgjet e tyre si të pas afatshme me të vetmin qëllim që nga fondi për pagesën e borgjeve që NSH ka ndaj kreditorëve të mos ju paguhen asnjëherë. Paditësja i propozoi gjykatës që kërkesën për një rishikim të vendimit ta aprovoje si të bazuar. Në mbështetje të ankesës së tij, paditësja dorëzoi kërkesën për pagesë të borgjit drejtuar NSH-së/AKP-së dhe faturat për periudhën 2006-2009.

Me 26 shtator 2018, AKP-ja ka dorëzuar në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka pohuar se i kundërshton të gjitha pretendimet e paditësit si të pa bazuara në ligj dhe si të tilla duhet të refuzohen. Paditësi nuk përmban bazën ligjore dhe asnjë listë të provave mbi të cilën do të mbështetet andaj kërkesa nuk i përmban të gjitha elementet që parashihen me nenin 27.2.4 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-033 për Dhomën e Posaçme dhe nenin 253 të LPK-së. E paditura më tej ka pohuar që qëndron në tersi pranë vendimit të kundërshtuar të AL i cili është i bazuar në nenin 374 të LMD-së (GZ 29/1978), që ka paraparë se kërkesat reciproke kontraktuale në sferën e shitjes së mallrave apo shërbimeve që lidhen me rimbursimin e shpenzimeve të bëra në lidhje me këto kontrata do të skadojnë për shkak të parashkrimit pas një periudhe tre vjeçare. E njëjta

përmbajtje lidhur me parashkrimet e së drejtës ekziston edhe me Ligjin e ri për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr.04/L-077), neni 357. E paditura propozoi që padia të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar. Në mbështetje të mbrojtjes në ankesë, e paditura dorëzoi vendimin e kundërshtuar të AL.

Më 01 tetor 2018, mbrojtja e të paditurës iu dorëzua paditësit. Asnjë përgjigje nuk u dorëzua nga paditësja.

Me 07 shkurt 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-13-4193 e refuzon ankesën e paditëses si të pabazuar, dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se me vjetërsimi/parashkrim, ligjërishit shuhet e drejta e kërimit përmbushjes së detyrimit, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftes se me ligj për raste të veqnat nuk është parashikuar diçka tjetër. Në rastin konkret e drejta për të kërkuar kompensimin për fatura të pa paguara është ligjërishit e vjetërsuar pas 3 viteve, pasi që NSH-ja nuk e ka përmbushur detyrimin e saj ndaj parashtruesit të kërkesës brenda këtij afati dhe pasi që paditësja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se ka paraqitur kërkesës në ndonjë procedurë gjyqësore, apo para ndonjë autoriteti kompetent brenda afatit 3 vjeçar, për të kërkuar borxhin e pretenduar dhe kështu për ta ndalur rrjedhën e afatit të parashkrimit. Sipas shkresave të lëndës rrjedh se paditësja kërkesën e ka parashtruar me 02 gusht 2013 lidhur me fatura e pa paguara për periudhën nga muaji prill 2006 deri në shtator 2009, që në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura çdo borgj vetëm se ishte parashkruar dhe kërkesa e tillë me të drejtë është refuzuar nga AL.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së po ashtu ka konstatuar se paditësja me parashtrimin e ankesës kundër vendimit të AL-së nuk ka pohuar ndonjë fakt apo argument ligjor që do të bënin ndryshimin e rrethanave faktike, sa i përket parashtrimin të së drejtës për të kërkuar në rrugë gjyqësore borxhin e pa paguar dhe kështu për të ndikuar në ndryshimin e vendimit të ankimuar. Po ashtu paditësja nuk ka paraqitur ndonjë provë për të dëshmuar faktin se ka iniciuar ndonjë procedurë gjyqësore, se ka parashtruar kërkesë për borxhin e pretenduar pranë organeve kompetente para ushtrimin të kërkesës pranë AL-së, kështu do të kishim ndërprerje të afatit të parashkrimit.

Sa i përket pretendimit për diskriminimin e paditëses si kreditor se AL si një autoritet jo gjyqësor i ka vlerësuar kërkesat si të parashkuara, Shkalla e I-rë e ka konsideruar si të pa bazuar, pasi që AL-ja nuk e ka rolin e gjykatës por është organ vendimmarrës dhe konform dispozitës së nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit 04/L0-34 të AKP-së ka pasur të drejtë që ta refuzojë kërkesën edhe mbi bazën e parashtrimit të vonuar/të parashkuar të së njëjtës.

Me 24 shkurt 2023, paditësja/ankuesja e ka dërguar një ankesë në DHPGJS të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së I-rë të DHPGS, C-IV-13-4193 të datës 07 shkurt 2023 për të gjitha bazat ankimore, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa e tij si e bazuar të anulohet aktgjykimi i atakuar dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te gjyqtari përkatës.

Paditësja në ankesën e parashtruar ka theksuar se ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore, duke i zbatuar tërësisht ato sepse kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor për parashtrimin e kërkesave pranë AKP-së. Po ashtu thekson se brenda afatit të caktuar kohorë komform paragrafit 1.3 të paragrafit 1 të nenit 17 të Ligjit për AKP-në, si dhe formularit të dërguar nga ky autoritet ka parashtruar pretendimet e saj ndaj NSH në likuidim për borxhin e kompensimit të ujit të pijes. Vendimi mbështet në nenin 374 të Ligjit për kontratat dhe Detyrimet (i publikuar në Gazetën Zyrtare RSFJ 29/1978 se " në varësi të dispozitave të mësipërme, kërkesa duhet te jete para gjykatës apo ndonjë autoriteti tjetër kompetent brenda tri viteve nga momenti kur ndërmarrja të mos ketë kryer kundrejt parashtruesit obligimet e saj që rrjedhin nga marrëdhënia tregtare, e që është tri vite nga viti 2009 kur parashtruesit nuk i është kryer pagesa e faturave të " KRU. "Radoniqi" SHA e kundërshton në tersi: së pari njoftimi në këtë proces që ju ka bërë kreditorëve në lidhje me borxhet e NSH që po privatizohet si dhe afatin e paraqitjes së kërkesës për pretendimet e tyre me të cilën gjatë tërë kësaj procedure të aplikimit pretenduesi i kërkesës KRU." Radoniqi" SH.A , ju ka përmbajtur në tersi. Ka shtuar se ai si kreditor i është përmbajtur afatit të caktuar të pranimit të kërkesave sipas këshillës në Formularin e AKP-së.

Paditësi, thekson se për shkaqet e përmendura me këtë ankesë, konsideron se Shkalla e I-rë- Dhoma e Posaçme nuk ka vepruar drejtë sepse në rastin konkret paditësja ka vepruar"-brenda afatit të caktuar kohor komfor nën paragrafit 1.3 të paragrafit 1 të nenit 17 të Ligjit për AKP-në si dhe formularit të dërguar nga ky

autoritet ka parashtruar pretendimet e saja ndaj NSH në likuidim për borxhin e kompensimit të ujit të pijes, mirëpo gjykata nuk ka konstatuar drejt gjendjes faktike dhe për këto arsye të lartpërmendura lidhur me çështjen juridikë të ankuesit nuk janë vërtetuar, respektivisht nuk janë qartësuar, kështu që nga ky lëshim i Gjykatës ka ardhur gjer tek vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike dhe gjer tek aplikimi i gabuar i së drejtës materiale.

Me 05 mars 2024, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS përgjigjen ndaj kësaj ankese. Në këtë parashtrësë AKP-ja ka pohuar se argumentet e veta qartësisht i ka sqaruar në mbrojtjen në ankesë, andaj përsëritja e tyre do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e paditëses refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësja KRU " Radoniqi", më 02 Gusht 2013, e ka parashtruar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit me të cilën ka kërkuar kompensimin për fatura të pa paguara të KB" KB Bashkimi"- Xerxë (në likuidim), në shumë prej 1,399.73 euro, e cila ishte refuzuar plotësisht , me arsyetimin se në bazë të Nenit 374 i Ligjit për kontratat dhe detyrimet (i publikuar në gazetën Zyrtare RSFJ 29/1978), parashikon që " Pretendimet reciproke kontraktuale në sferën e shitjes së mallrave apo shërbimeve si dhe kërkesave që lidhen me

rimbursimin e shpenzimeve të bëra në lidhje me këto kontrata do të skadojnë për shkak të parashkrimit pas një periudhe tre vjeçare.

Kundër vendimit të AL (AL) PRZ067-0003, të datës 02 dhjetor 2013, paditësja kishte paraqitur ankesë dhe ka pohuara se nuk ka parashkrim të kërkesës karshi një autoriteti jo gjyqësor andaj vendimit i AL është në kundërshtim me procedurën e privatizimit me të cilin ka udhëhequr ky autoritet. Paditësja me tej kishte pohuar se ky është një diskriminim që po i bëhet kreditorëve duke i vlerësuar kërkesat si të parashkruara nga një autoritet jo gjyqësor me Shtojcën e Ligjit nr.04/L-034 për AKP- në me qëllim të vlerësimit të këtyre borgjeve si të pas aftshme e cila nxirret me vonë dhe me këtë diskriminon kreditorët duke i konsideruar borgjet e tyre si të pas afatshme me të vetmin qëllim që nga fondi për pagesën e borgjeve që NSH ka ndaj kreditorëve të mos ju paguhen asnjëherë.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-13-4193 e ka refuzuar ankesën e paditëses si të pabazuar, dhe e ka vërtetuar Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në Ligj.

Kolegji i Apelit pas shqyrtimi të pretendimeve të palëve dhe duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë nga Shkalla e I-rë , pasi që aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin e Shkalles së I-rë ku ka konstatuar se me vjetërsimi/parashkrim, ligjërisht shuhet e drejta e kërimit përmbushjes së detyrimit, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftes se me Ligj për raste të veqnat nuk është parashikuar diçka tjetër. Në rastin konkret e drejta për të kërkuar kompensimin për fatura të pa paguara është ligjërisht e vjetërsuar pas 3 viteve, pasi që NSH-ja nuk e ka përmbushur detyrimin e saj ndaj parashtruesit të kërkesës brenda këtij afati dhe pasi që paditësja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se ka paraqitur kërkesës në ndonjë procedurë gjyqësore, apo para ndonjë autoriteti kompetent brenda afatit 3 vjeçar, për të kërkuar borxhin e pretenduar dhe kështu për ta ndalur rrjedhën e afatit të parashkrimit.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja kërkesën lidhur me faturat e pa paguara për periudhën nga muaji prill 2006 deri në shtator 2009, tek Autoriteti i Likuidimit e ka parashtruar me 02 gusht 2013, që në bazë të dispozitës së nenit 374 të Ligjit Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, (botuar në gaztën Zyrtare të RSFJ-së nr.29/1978) si Ligji i zbatueshëm në kohën kur është krijuar detyrimi, i bie që borgji të cilën e kërkon e paditësja për periudhën e lartcekur me se largu në muajin tetor 2012, ishte parashkruar dhe kërkesa e tillë me të drejtë është refuzuar nga Shkalla e I-rë.

Paditësja me parashtrimin e ankesës në Shkallën e II-të po ashtu nuk ka pohuar ndonjë fakt apo argument ligjor që do të bënin ndryshimin e rrethanave faktike, sa i përkëte parashtrimin të së drejtës për të kërkuar në rrugë gjyqësore borxhin e pa paguar dhe kështu për të ndikuar në ndryshimin e vendimit të ankimuar. Po ashtu paditësja përveç pretendimeve nuk ka paraqitur ndonjë provë për të dëshmuar faktin se ka iniciuar ndonjë procedurë gjyqësore, se ka parashtruar kërkesë për borxhin e pretenduar pranë organeve kompetente para ushtrimit të kërkesës pranë AL-së dhe kësisoj për ta ndërprerë afatin e parashkrimit.

Prandaj duke u bazuar në këto arsye, është i sakte rezultati i dhënë me aktgjykimin e ankimuar nga ana e Shkallës së I-rë. Prandaj nga këto arsye ankesa e paditëses refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore:

Paditësja e ka paguar taksën gjyqësore me datë 11 prill 2024, për procedurën ankimore në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit, me datë 20 qershor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtari kryesues _____